

## KOMITETI DREJTUES

Nr. 59 Prot.

Tiranë, 8 gusht 2023

### Vendim Nr. 5 i KD-së

Komiteti Drejtues i FSHB-së në mbledhjen më datë 7 gusht 2023, drejtuar nga Presidenti, Z. Avni Ponari dhe prezencë të anëtarëve, Znj. Edera Alibegaj, Znj. Migena Plasa dhe Z. Klevis Kaso, duke formuar kuorumin e domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes, diskutuan mbi rendin e ditës si vijon:

1. Reflektimet e shoqatave anëtare lidhur me ndryshimet në Rregulloren e Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit;
2. Të ndryshme.

Komiteti Drejtues diskutoi një për një problematikat e trajtuara dhe pse vetëm 7 nga 24 shoqatat anëtare janë prononcuar lidhur me kërkesën e adresuar nga FSHB për reflektimet mbi ndryshimet e bëra në Rregulloren e Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit. Shoqatat që paraqitën reflektim ishin:

1. Shoqata Flamurtari;
2. Shoqata Skënderbeu;
3. Shoqata Partizani Basket;
4. Shoqata Eagles Basket – Besëlidhja;
5. Shoqata Apollonia;
6. Shoqata Fieri Basket 2008;
7. Shoqata Teuta Basket (*pa ndonjë propozim të veçantë*).

U trajtua mënyra e organizimit të kampionatit kombëtar për meshkuj. Pjesëmarrja në Ligën Unike si një obligim që rrjedh nga marrëveshja ndërmjet dy federatave, si dhe marrëveshjes ndërqeveritare të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Përfshirja e lojtarëve të huaj në kampionatet kombëtare. Rivlerësimi i shpërblimeve për ekipet fituese në veprimtaritë kombëtare, etj.

**Për sa më sipër KD-ja vendosi:**

1. Pasqyrim të ndryshimeve në Rregulloren e Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit.
  - Organizimi i kampionatit kombëtar të rritur/a 2023-24 me një grup;
  - Përfshirja Ligës Unike meshkuj dhe femra sipas kushteve të pjesëmarrjes, mbështetja financiare e FSHB-së për ekipet pjesëmarrëse nga Shqipëria, si dhe rastet e refuzimit apo tërheqjes nga Liga Unike;
  - Organizimi i kampionatit kombëtar U18 djem me Kategorinë e I-rë dhe të II-të;
  - Miratoj vendimin për 3 (tre) lojtarë të huaj në fushë gjatë ndeshjeve të kampionateve kombëtare meshkuj dhe femra;
  - Sigurim i transmetimit të çdo ndeshje në kampionatet kombëtare meshkuj dhe femra të rritur/a;
  - Akordim i 60 % të shumës nga tarifa e transferimit të lojtarëve vendas për shoqatën nga ku transferohet lojtari;
  - Përcaktimi i tarifave të regjistrimit për lojtarët e huaj;
  - Rritja e shpërblimeve për ekipet fituese dhe përfshirja në shpërblim e ekipeve finaliste në aktivitetet kombëtare të FSHB-së.